

UDHËZIM
Nr. 41, datë 9.11.2006

PËR ZGJEDHJEN E LITERATURËS NDIHMËSE, JOARTISTIKE, NË SHKOLLAT E
ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Në zbatim të nenit 102 të Kushtetutës së Shqipërisë, të nenit 52 pika 1 dhe nenit 53 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, ndryshuar me ligjin nr.8387, datë 30.7.1998,

UDHËZOJ:

1. T’u rekomandohet nxënësve të shkollave/kopshteve të arsimit parauniversitar literaturë ndihmëse, në vijim të urdhrit nr.76, datë 13.3.2006 “Për krijimin dhe funksionimin e bordit të rekomandimit të literaturës artistike, studimore e publicistike”.

2. Për realizimin e synimeve të programeve lëndore që zhvillohen në kopshtet e fëmijëve dhe shkollat e arsimit parauniversitar, përveç teksteve mësimore, të përdoret literaturë ndihmëse, e cila nuk është e detyrueshme për procesin mësimor.

3. Literaturë ndihmëse për shkollat e arsimit parauniversitar të konsiderohet ajo literaturë që nuk është në katalogun e teksteve shkollore të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

4. Literatura ndihmëse të blihet në libraritë ose dyqane të tjera, që e marrin përsipër këtë shërbim.

5. Mësuesit lëndorë dhe edukatorët e kopshteve të këshillojnë nxënësit/fëmijët parashkollorë dhe prindërit e tyre për blerjen e literaturës ndihmëse.

6. Literatura ndihmëse t’u rekomandohet të gjithë nxënësve të klasës ose një pjese të saj, p.sh. nxënësve me arritje të larta lëndore ose arritje të ulëta.

7. Nxënësi/fëmija parashkollor nuk duhet të detyrohet që ta sjellë literaturën ndihmëse në klasë.

8. Për një lëndë të rekomandohen jo më shumë se dy botime ndihmëse në vit, me përjashtim të revistave.

9. Procedurat e përzgjedhjes së literaturës ndihmëse, që u rekomandohet nxënësve/fëmijëve parashkollorë përshkruhen në aneksin e këtij udhëzimi.

10. Të mos jenë autorë të literaturës ndihmëse:

a) Punonjësit e MASH-it;

b) Punonjësit e DAR/ZA-ve për shkollat nën juridiksionin e tyre.

11. Në një shkollë apo kopsht fëmijësh të mos rekomandohet literatura ndihmëse me autor punonjës të asaj shkolle/kopshti.

12. Në këtë udhëzim nuk përfshihet përzgjedhja e literaturës artistike, studimore e publicistike për lëndën e letërsisë dhe gjuhës shqipe, e cila bëhet nga lista rekomanduese e librave artistikë, studimorë e publicistikë, që MASH ka dërguar për këtë qëllim në DAR/ZA.

13. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi DAR/ZA dhe drejtoritë e shkollave.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Genc Pollo

ANEKS

I UDHËZIMIT NR.41, DATË 9.11.2006 TË MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS “PËR
ZGJEDHJEN E LITERATURËS NDIHMËSE, JOARTISTIKE, NË SHKOLLAT E ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR”

1. Autorët ose botuesit e literaturës ndihmëse të dërgojnë në fillimin e vitit shkollor ose në fillim të semestrit të dytë nga një kopje të literaturës ndihmëse në DAR/ZA ose në shkolle/kopshte fëmijësh (mundet edhe me të drejtë kthimi).

2. Drejtorët e shkollave/kopshteve të marrin nga një kopje të literaturës ndihmëse në DAR/ZA.

3. Komisionet lëndore të shqyrtojnë literaturën ndihmëse të ofruar. Në shkollat/kopshtet ku ka

vetëm një mësues lëndor, procedura të realizohet nga ai mësues.

a) Komisioni të vendosë me shumicë votash dy, një ose asnjë libër ndimës për lëndë/klasë (Me “shumicë votash” kuptojmë më shumë se gjysma e anëtarëve të komisionit lëndor.).

b) Nëse numri i votave është i barabartë, vendimi të merret sipas vendimit të mësuesit lëndor të klasës.

c) Vendimi t’i njoftohet me shkrim drejtorit.

d) Në njoftimin me shkrim të shkruhen emrat e mësuesve që kanë votuar “për” dhe “kundër”. Ky njoftim të firmoset nga kryetari i komisionit lëndor.

e) Drejtori i shkollës të afishojë listën me literaturën ndihmëse, të zgjedhur për çdo lëndë.

f) Drejtori i shkollës të ruajë për tre vjet procesverbalin dhe vendimin t’ua paraqesë eprorëve sa herë ata ta kërkojnë.

4. Drejtori të afishojë në sallën e këshillit të mësuesve këtë udhëzim bashkë me aneksin e tij, para se të nisë procesi i miratimit të literaturës ndihmëse.